



## **AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**

### **NJËSIA E KËRKIMIT PËR BIOTEKNOLOGJITË DHE GJENETIKËN**

#### **MBI ZHVILLIMIN E FORUMIT TË NJËSISË SË KËRKIMIT NË BIOTEKNOLOGJI DHE GJENETIKË**

Më 18 Shtator 2020 në mjediset e Akademisë së Shkencave, Njësia e Kërkimit për Bioteknologjinë dhe Gjenetikën organizoi forumin “*Mbi gjendjen e kërkimit shkencor dhe perspektiva në Bioteknologji dhe Gjenetikë në Shqipëri*”. Forumi u organizua në kuadrin e veprimtarive të programuara pas ngritjes së Njesisë në muajin shkurt të këtij viti. Në këtë veprimtari morrën pjesë: Kryetari i Akademisë së Shkencave, akademik Skënder Gjinushi, Nën kryetari i Akademisë së Shkencave Akademik Vasil Tole, Sekretari i Akademisë së Shkencave Akademik Shaban Sinani, Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike Akademik Neki Frashëri, drejtues të Universiteteve dhe institucioneve të tjera kërkimore shkencore, kërkues shkencorë të fushave të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës si dhe të ftuar të tjerë.

Veprimtaria u përshëndet nga Kryetari i Akademisë së Shkencave akademik Skënder Gjinushi. Në fjalën e tij përshëndetëse, ai theksoi rëndësinë e ngritjes së Njesisë dhe të rolit të saj në organizimin, nxitjen dhe koordinimin e veprimtarisë shkencore të grupeve apo institucioneve të ndryshme në fushat e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës edhe pse vështirësitë janë të shumta. Ai theksoi se pavarësisht nga vështirësitë, vendit tonë nuk i mungojnë njerëzit dhe kërkuesit e talentuar, që punojnë në institucione të ndryshme, veprimtaria e të cilëve duhet më mirë të koordinohet, të rritet efikasiteti i punës së tyre nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të të gjitha mundësive që ofrohen. Nga ana tjetër, duhet të kuptohet mirë rëndësia dhe nevoja e investimeve në fushën e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës. Në këtë kuptim, u theksua gjithashtu, mbështetja e vazhdueshme e Akademisë së Shkencave për arritjen e qëllimit të përbashkët të zhvillimit shkencor.

Forumit u përshëndet edhe nga bashkëdrejtuesja e Njesisë së Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, akademike Efigjeni Kongjika, në pamundësi për të marrë pjesë drejtpërdrejt në forum, e cila theksoi se pavarësisht rezultateve të deritanishme të grupeve kërkimore, ka vend për të kërkuar rezultate madhore për kalimin e produktit bioteknologjik, të krijuar nga projektet deri në shkallë të gjerë për stimulimin e bizneseve në tregun e brendshëm apo rajonal e me gjerë. Krijimi i Rrjeteve dhe ngritja e Qendrave elitare janë mjet për të qenë të aftë për vazhdimin e punës dhe konkurrues me vendet më të zhvilluara të rajonit.

Në fjalën e hapjes së veprimtarisë, akademik Ilia Mikerezi theksoi se forumi ka si qëllim kryesor diskutimet dhe shkëmbimin e mendimeve në lidhje me:

- evidentimin e gjendjes së kërkimit shkencor në këto fusha;
- evidentimin e potencialeve njerëzore dhe të infrastrukturës;
- diskutimin e mundësive për formimin e një rrjeti kombëtar për studime shkencore të koordinuara;
- përshtatjen më mirë të studimeve në lidhje më të ngushtë me zgjidhjen e problemeve më shqetësuese të ekonomisë, mbrojtjes së mjedisit, shëndetit etj.;
- rritjen e eficiencës dhe vënien në funksionim të laboratorëve, ku janë investuar mjete financiare të konsiderueshme;
- ngritjen e strukturave të reja bashkëkohore kërkimore shkencore në funksion të studimeve si dhe të bashkëpunimit në shkallë të gjerë midis specialistëve të fushave;
- gjetjen e mënyrave më efektive për të shkëmbyer përvojat pozitive midis grupeve të ndryshme kërkimore, që operojnë në të njëjtat drejtime shkencore, si dhe të atyre që punojnë në fusha të ngjashme etj.

Gjatë zhvillimit të forumit u paraqitën 25 referate. Diskutimet e pjesëmarrësve u zhvilluan në katër sesione të ndara sipas fushave të ndryshme, të cilat përfshinin: Bioteknologji Mjekësore, Gjenetikë e popullatave, Bioteknologji Farmaceutike, Bioteknologji Bimore, Bioteknologji Zoo-Veterinare dhe Akuakulturë, Bioteknologji Ushqimore, Bioteknologji Mjedisore, Biomatematikë dhe Biofizikë. Forumi mbledhi së bashku në debat kërkues shkencorë të Fakultetit të Mjekësisë, të Departamentit të Farmacisë, Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, të Institutit të Shëndetit Publik, të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, fakulteteve të ndryshme të Universitetit Bujqësor të Tiranës, Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Vlorë, të Universitetit të Sporteve. Kërkues të njohur në këto fusha si akademikët Genc Sulcebe, Ilia Mikerezi, Efigjeni Kongjika, Ilirjan Malollari, profesorët Marenglen Spiro, Rigerta Sadikaj, Anila Babameto, Irena Seferi, Ledjan Malaj, Vilma Papajani, Dhurata Bozo, Ariola Bacu, Valbona Sota, Alban Ibraliu, Magdalena Cara, Anila Hoda, Lumturi Papa, Enkelejda Sallaku, Rozana Troja, Laura Shabani, Luljeta Pinguli, Vlash Mara, Xhelil Koleci, Aida Bani, Renata Kongoli, Rigerta Sadikaj, por edhe kërkues më të rinj si Renis Maçi, Vjola Bakillari, Vilma Gurazi, si dhe profesorë shqiptarë që punojnë suksesshëm në universitete europiane si Erida Gjini, Blerina Sinimeri, Albana Topi u bënë pjesëmarrës aktivë në referimet e tyre dhe debatet gjatë forumit.

Krahas diskutimeve në lidhje me problemet e mësipërme, gjatë forumit u paraqitën edhe rezultate të punimeve shkencore në fushat përkatëse.

Në diskutimet e pjesëmarrësve u evidentua qartë fakti se, pavarësisht nga vështirësitë e shumta në disa raste, ka një rritje cilësore të infrastrukturës laboratorike e bazuar kjo, veçanërisht në projektet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme ndërkombëtare. Kjo ka ndikuar edhe në përmirësimin e cilësisë së disa punimeve kërkimore. Sigurisht kjo është e pamjaftueshme, prandaj u theksua kërkesa për rritje të investimeve në infrastrukturë. Nga ana tjetër, duhet shfrytëzuar më mirë infrastruktura ekzistuese, sepse ende kemi rendimente të ulëta shfrytëzimi.

Në shumë raste, si rezultat i shkëmbimeve me jashtë, rezultoi nga punimet e paraqitura, se ka një rritje të cilësisë së përgatitjes teorike dhe praktike të stafit, por që puna kërkimore e tij nuk ka ende ritmet e kërkuara. Nga ana tjetër, u vunë në dukje mjaft raste të bashkëpunimeve të frytshme midis kërkuesve apo grupeve kërkimore brenda vendit, por që janë ende të pakta. Po kështu edhe në

lidhje me bashkëpunimet me institucione apo grupe kërkimore jashtë vendit, niveli i të cilave duhet shumëfishuar dhe duhet përfituar më mirë. Disa kërkues paraqiten dhe mundësi të realizimit të projekteve pilot me bashkëpunim të grupeve kërkimore në Rrjete të propozuara të institucioneve të ndryshme, universitete apo institute shkencore.

Në disa raste të tjera u theksuan edhe probleme të ndryshimeve ligjore, të cilat rregullojnë aspekte të ndryshme të punës kërkimore shkencore të lidhura këto me problemet e investimeve, patentimeve, akreditimit të laboratorëve kërkimore apo edhe elementëve të tjerë. Organet dhe institucionet e ndryshme shtetërore duhet të dëgjojnë më shumë zërin dhe mendimin shkencor të studiuesve tanë. Gjithashtu, duke patur parasysh punën e rëndësishme që kryhet edhe në përgatitjen studimeve në nivelin e doktoraturave u tërhoq vëmendja në zgjidhjen ligjore të organizimit të tyre.

Me evidentimin e problemeve të mësipërme, pas marrjes së një informacioni të vlefshëm mbi gjendjen e zhvillimit në fusha të ndryshme të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, sipas objektivave të përcaktuara dhe sipas punës së planifikuar, njësia do të zhvillojë vitin e ardhshëm një konferencë shkencore me pjesëmarrje të kërkuesve vendas dhe të huaj.

Akad. Efigjeni Kongjika

Akad. Ilia Mikerezi

Tiranë, 20.09.2020